

Disiplina/ Kukesi penalizohet me tre pike, Shensoji pezullohet 12 ndeshje

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 11 Dhjetor 2013 16:28



Komisioni I Disiplines ka vendosur te denoj Kukesin per ngjarjet e dhunes ne ndeshjen me Skenderbeu. Klubi verilindor ka marre si penalitet heqjen e tre pikeve qe rendojne edhe me shume pozitat e nenkampioneve. Tentativa e disa civileve per te goditur gjyqtarin Enea Jorgji ka sjelle kete denim te rende per skuadre e presidentit Safet Gjici dhe investimin e tij. Gjithashtu Kukesi do te luaj kater ndeshje jashte fushes se vet dhe per te mos mbaruar ketu, trajneri Naxhi Shensoji per sjellje antisportive te perseritur denohet me 12 ndeshje pezullim.